



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Tafana Kono

Kif

Aranka Cang

Belsara Bocsi

Isida Monopari

Belva Dushi
POV

Nr. 751/2 Prot.

Vlorë më, 24.2.2025

VENDIM
Nr. 15, datë 24.02.2025

PËR

**MIRATIMIN E PRAGUT TË NOTËS MESATARE QË I JEP TE DREJTË
STUDENTIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË TË DIPLOMOHET DUKE
PREGATITUR DHE MBROJTUR NJË PUNIM TEME DIPLOME NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 38, 73, pika 2 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe referuar shkresës 60/2 datë 31.01.2025 të Dekanës së Fakultetit Ekonomik, Senati Akademik në mbledhjen e datës 24.02.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë prapun e notës mesatare që i jep të drejtën studentit të diplomohet duke përgatitur një punim diplome, si më poshtë vijon:
 - a. Studentët e Ciklit të Parë të Studimeve, në programet Bachelor, diplomohen me provim përfundimtar ose punim teme diplome në fushën e studimit të kryer. Të drejtën për të zgjedhur përfundimin e studimeve me punim teme diplome e kanë vetëm studentët me mesatare note ≥ 8 (tetë).
 - b. Studentët e Ciklit të Dytë të Studimeve, Master Profesional, diplomohen me provim përfundimtar ose punim teme diplome në fushën e studimit të kryer. Të drejtën për të zgjedhur përfundimin e studimeve me punim teme diplome e kanë vetëm studentët me mesatare note ≥ 7 (shtatë).
2. Numri i udhëheqjeve të temave të studimit varet nga kapacitetet e udhëheqjes shkencore të stafit akademik me kohë të plotë të Departamentit / Fakultetit që ofron programin.
3. Në fillim të çdo viti akademik Drejtuesi i Njesisë Kryesore deklaron tek Zv.Rektori Akademik (që monitoron ngarkesën mësimore të stafit akademik) kapacitetet maksimale të udhëheqjeve të temave të diplomës në nivel departamenti / fakulteti për atë vit akademik. Këto kapacitete përfshijnë maksimumin e mundësive dhe disponibilitetit për udhëheqje shkencore që ka personeli akademik i njesisë kryesore për vitin në vijim, pasi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

të jenë përjashtuar udhëheqjet shkencore aktuale, në proces nga vitet e mëparshme dhe në proces në institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit.

4. Prej këtyre kapaciteteve së pari plotësohen detyrimet për udhëheqje shkencore në programet Master Shkencor dhe Doktoratë, që e kanë të detyrueshme përfundimin e studimeve me punim shkencor. Pasi plotësohen detyrimet për këto programe, merren në shqyrtim kërkesat nga programet Master Profesional dhe Bachelor.
5. Nëse kapacitetet e stafit akademik me kohë të plotë të Departamentit, janë më të ulëta sesa numri i kërkesave, atëherë dhënia e mundësisë për mbylljen e studimeve me temë diplome në programet Master Profesional dhe Bachelor do të bëhet sipas rendit zbritës të mesatares së ponderuar të studentëve për rezultatet e arritura deri përpara fillimit të semestrit të Pranverës, kur do të jepet e drejta për tu diplomuar me temë diplome.
6. Përpara prezantimit punimi i diplomave do i nënshtrohet sistemit antiplagjaturë të UV-së. Nëse vlerësimi antiplagjaturë gjen më tepër se 25% përputhshmëri, tema e propozuar nuk pranohet për mbrojtje diplome.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, çdo vendim i mëparshëm shfuqizohet
8. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Zëvendësrektorit Akademik, Njësive Kryesore dhe Sektorit të Kurrikulave dhe Statistikave në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

